

D E K R E T
Nr.1615, datë 20.9.1996

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 7926, DATË 20.4.1995 “PËR TRANSFORMIMIN E
NDËRMARRJEVE SHTETËRORE NË SHOQËRI TREGTARE”**

Në mbështetje të nenit 28, pika 19, të ligjit nr. 7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

D E K R E T O J :

Neni 1

Neni 4 i ligjit nr. 7926, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, ndryshohet si më poshtë:

“Shteti, si pronar i vetëm i kapitalit të shoqërive, përfaqësohet nga:

1. Ministria e Burimeve Minerare dhe Energjetike për:

- Korporatën Elektroenergjetike Shqiptare (KESH)
- Albpetrol
- Albkrom
- Albbakër
- Gjeoalba

2. Ministria e Financave për:

- Bankën Kombëtare Tregtare
- Bankën Tregtare Agrare
- Bankën e Kursimeve
- Institutin e Sigurimeve (INSIG)

3. Ministria e Industrisë, Transporteve dhe Tregtisë për:

- Portet detare në Durrës, Vlorë, Shëngjin, Himarë dhe Sarandë
- Albtransportin (Aeroportin e Rinasit)
- Ndërmarrjen e hekurudhave
- Ndërmarrjen e prodhimit të kripës në Vlorë
- Regjistri Detar në Durrës
- Agjencia e trafikut ajror (ANTA)

4. Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit për:

- Institutet e kërkimeve shkencore të sistemit të bujqësisë dhe ushqimit
- Ndërmarrja e ujërave të sistemit të bujqësisë

5. Ministria e Mbrojtjes për:

- Ndërmarrjet e prodhimeve ushtarake në Poliçan, Gramsh dhe Mjekës.
- Uzinat e riparimit të avionëve, tankeve, artilerisë
- Shtëpitë e pushimit të ushtarakëve, Durrës dhe Pogradec
- Enti social-kulturor i ushtrisë

6. Ministria e Shëndetësisë dhe Ambientit për:

- Institutin e Sigurimeve Shëndetësore

7. Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale për:

- Institutin e Sigurimeve Shoqërore

8. Ministria e Punëve Publike, Rregullimit të Territorit dhe Turizmit për:

- Ndërmarrjet e prodhimit dhe shpërndarjes së ujërave
- Hotelet e sistemit të Albturizmit

9. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Gruas për:

- Qendrën Ndërkombëtare të Kulturës, Tiranë
- Kinostudion, Tiranë

10. Ministria e Arsimit dhe Sporteve për:

- Ndërmarrjen e shpërndarjes së librit shkollor

11. Departamenti Shtetëror i Postave dhe Telekomunikacioneve për:

- Telekomin
- AMC
- Ndërmarrjen e Postave.

Për të gjitha shoqëritë e tjera tregtare, ndërmarrjet e tjera shtetërore të patransformuara dhe objektet e veçanta që shkëputen nga shoqëritë e tjera tregtare, shteti, si pronar i vetëm i kapitalit, përfaqësohet nga Ministria e Privatizimeve.

Për objektet që janë në administrim të ministrive dhe institucioneve të tjera qendrore dhe organeve të pushtetit lokal, si dhe për shoqëritë e reja tregtare, të krijuara nga transferimi i pasurive të këtyre institucioneve, mënyra e privatizimit dhe organi përfaqësues i shtetit si pronar përcaktohen me akte të Këshillit të Ministrave.

Ministritë, Departamenti Shtetëror i Postave dhe Telekomunikacioneve dhe Ministria e Privatizimeve, sipas përkatësisë të përmendur më lart, nënshkruajnë kapitalin themeltar të shoqërive dhe ushtrojnë të drejtën e pronarit të këtyre shoqërive për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare, si dhe për përgatitjen për privatizimin tërësisht ose pjesërisht të tyre”.

Neni 2

Neni 6 i ligjit nr. 7926, datë 20.4.1995, ndryshohet si vijon:

“Ministria e Privatizimeve dhe ministritë e institucionet e tjera, sipas përkatësisë të përcaktuar në nenin 4 të këtij ligji, në bashkëpunim me organin e vartësisë së ndërmarrjes shtetërore të patransformuar, drejtojnë punën për hartimin e akteve të themelimit të shoqërive që krijohen nga transformimi i ndërmarrjeve dhe autorizon regjistrimin e tyre”.

Neni 3

Neni 7 i ligjit nr. 7926, datë 20.4.1995, ndryshohet si vijon:

“Regjistrimi i shoqërive tregtare që krijohen nga transformimi i ndërmarrjeve, do të kryhet brenda datës 31.7.1997.

Për çdo drejtues të ndërmarrjeve shtetërore, i cili ka penguar procesin e transformimit dhe regjistrimin e ndërmarrjeve në shoqëri tregtare brenda afatit të parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni, merren masat përkatëse disiplinore”.

Neni 4

Neni 8 i ligjit nr. 7926, datë 20.4.1995, ndryshohet si më poshtë:

“Organet drejtuese të shoqërive anonime janë:

- Këshilli mbikëqyrës
- Drejtoria

Këshilli mbikëqyrës përbëhet nga 3 deri në 9 anëtarë, të cilët nuk janë të punësuar në shoqëri. Anëtarët e keshillit mbikëqyrës emërohen nga organi me cilësinë e përfaqësuesit të pronarit.

Drejtoria emërohet dhe shkarkohet nga keshilli mbikëqyrës, kur për të bie dakord jo më pak se tre të katërtat e keshillit mbikëqyrës.

Shpërblimi i veçantë për pjesëmarrje në keshillin mbikëqyrës dhe shpërblimet e jashtëzakonshme për shërbimet dhe detyrat që u caktohen anëtarëve të keshillit, rregullohen me vendim të Keshillit të Ministrave.

Neni 109 i ligjit nr. 7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”, nuk zbatohet për atë kohë sa shteti do të jetë aksionar i vetëm i këtyre shoqërive dhe për atë kohë sa të punësuarit e shoqërive janë njëherazi edhe aksionarë të tyre.

Bëjnë përjashtim nga rregullat e mësipërme bankat tregtare dhe institutet e sigurimeve dhe shkencore, ku organet drejtuese përcaktohen me ligjet e veçanta të krijimit dhe funksionimit të këtyre institucioneve”.

Neni 5

Në dokumentet e regjistrimit në gjykatë të shoqërive të krijuara para hyrjes në fuqi të këtij

dekreti, të bëhen ndryshimet përkatëse në përputhje me nenin 4 të këtij ligji, përsa i përket përfaqësuesit të pronarit shtetëror.

Neni 6

Nenet 5 dhe 16, si dhe ligji nr. 7996, datë 20.9.1995 "Për miratimin e dekretit 1195, datë 14.8.1995", ligji nr. 8067, datë 15.3.1996, si dhe ligji nr. 8099, datë 28.3.1996, shfuqizohen.

Neni 7

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

KUNDËRFIRMOHET
KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
Sali Berisha